



Viti i VII-të i Botimit, Nr.1,
Qershorë 2016

NDËRLIDHJA MIDIS PATOLOGJIVE ORALE DHE SËMUNDJEVE SISTEMIKE

Erda Qorri*, Artan Mesi**, Aida Ymeri***, Rezart Qorri***

* Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekësore

** Spitali Rajonal Shkodër

*** Klinikë Private Shkodër

**** Klinikë Private “Dentalance”, Gjermani

Adresë kontakti: erdaqorri@gmail.com

Përmbledhje

Shumë sëmundje sistemike, siç janë diabeti, artriti, osteoporoza, AIDS, si dhe terapitë për sëmundjet sistematike, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, mund të komprometojnë indet e buta të kavitetit oral.

Si pasojë, në kavitetin oral shfaqen lëzime të ndryshme patologjike, të cilat mund të jenë të vetme ose të shoqëruara me lëzime të tjera në nivelin e tegumenteve. Shpeshherë ato mund të jenë shenja paralajmëruese të patologjive sistematike ose mund të jenë pasojë e këtyre patologjive komprometuese të sistemit imunitar human.

Në këtë punim janë ekzaminuar 250 pacientë, të cilët i janë nënshtruar ekzaminimeve klinike dhe analizave laboratorike për të përcaktuar llojin e lëzimit dhe bashkëzistencën e tij me sëmundje sistematike të asociuara.

Qëllimi i studimit:

- Të identifikohen lëzionet orale në pacientë sipas patologjisë specifike të përgjithshme.
- Matja e thellësisë së xhepave periodontalë dhe e indeksit.
- Ekzaminimi bakteriologjik i likidit sulkular pas mbjelljes në terren ushqyes: agar-gjak.

Konkluzionet: Në bazë të rezultateve të arritura pas ekzaminimit të pacientëve, diagnostikimit të patologjive dhe manifestimeve orale, u arrit në këto konkluzione: *Prevalencë e lartë për gingivit, periodontit, kandida, halitosis, glosit në pacientë me patologji renale, hepatike, hematologjike dhe diabet.* Grupmosha me risk më të lartë është 50-70 vjeç, krahasuar me mosha më të reja. Gjinia më e rëkshur janë meshkujt, të cilët paraqiten në raportin 2:1 me femrat.

Fjalë çelës: lëzion, halitosis, gingivit, likid sulkular.

THE CORRELATION BETWEEN ORAL MANIFESTATIONS OF SYSTEMIC DISORDERS

Abstract

Many systemic diseases such as diabetes, arthritis, osteoporosis, and AIDS, as well as therapies for systemic diseases, can directly or indirectly compromise oral tissues. The World Health

Organization's *International Classification of Diseases and Stomatology* currently lists more than 120 specific diseases, distributed in 10 or more classes that have manifestations in the oral cavity (WHO 1992).

In oral cavity it can be observed different lesions that could be singular or associated with other lesions situated at the level of the skin. They can be warning signs of systemic pathologies, or may be due to those pathologies that compromise the human immune system.

In this study 250 patients are examined. The patients were subjected to clinical examinations and laboratory tests to determine the type of lesion and its coexistence with the associated systemic disease.

The aim of this study is to identify the oral lesions according to the general systemic pathology. The depth of periodontal pockets and index were measured. Also bacteriological examination of fluid on the ground after planting sulcular liquid in blood agar was carried out.


Conclusion: In this study *higher prevalence for gingivitis, periodontitis, candida albicans, halitosis, glossitis in patient with renal pathology, hepatic, hematologic and diabetes* was observed. The higher risk group is from 50 – 70 years old. Men are at higher risk than women in a relation of 2:1.

Key words: lesion, halitosis, gingivitis, sulcular liquid.


Shumë sëmundje sistemike, siç janë diabeti, artriti, osteoporoza, AIDS, si dhe terapitë për sëmundjet sistemike, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, mund të komprometojnë indet e buta të kavititetit oral.¹ Lezionet orale të shfaqura në nivelin e kavititetit oral, janë të formave dhe të madhësive të ndryshme. Ato mund të jenë pasojë ose jo e patologjive dento-alveolare. Nëse i referohemi lezioneve orale të shfaqura në nivelin e mukozave të kavititetit oral të cilat nuk kanë lidhje me patologjitë dentare, duhet të kushtojmë një vëmendje më të madhe gjatë ekzaminimit klinik, pasi prezenca e tyre mund të jetë e lidhur me një manifestim beninj ose malinj, i cili mund të shfaqet i vetëm ose i asociuar me leziona të tjera në nivelin e tegumenteve². Gjithashtu, këto leziona mund të shfaqen si pasojë e problemeve të sistemit imunitar të pacientit, të cilat, të depistuar në kohë nga klinikisti stomatolog, mund të ndihmojnë në kurimin e tyre në kushte të favorshme, duke ndihmuar në këtë lloj mënyre përmirësimin e kushteve të jetesës së këtyre pacienteve³.

Në këtë studim janë marrë në shqyrtim 250 raste klinike. Pacientët i janë nënshtruar një anamneze rigoroze, ekzaminimit extra-oral dhe ekzaminimit klinik intra-oral. Është realizuar matja e thellësisë së xhepave periodontalë atëherë kur ato kanë qenë të pranishme, si dhe është kryer marrja e likidit me tamponë pambuku sterile dhe është mbjellë në terren ushqyes agar-gjak për ekzaminimin bakteriologjik.

Pacientët e ekzaminuar i përkasin pavijoneve spitalore të qytetit të Shkodrës dhe Klinikës Universitare të “Albanian University”. Në pavijonin e kardiologjisë të Spitalit Rajonal të Shkodrës janë ekzaminuar 77 pacientë, nga të cilët 31 janë femra dhe 46 janë meshkuj. Ata i përkasin grupmoshës 55-85 vjeç. Diagnozat e përgjithshme të pacientëve ishin kryesisht cord pulmonar, agor dhe insuficiencë kardiake. Te këta pacientë, falë medikamenteve të përdorura, por dhe të patologjive të tipit Diabet Miellistus të asociuara, është vënë re një *xerostomi* e cila favorizonte shfaqjen e *candida albicans*, me shprehjen e *fisurave komisurale eritematoze* të kongjestionuara⁴. Te pacientet të cilët kishin një status dento-parodontal të pranshëm, u bë dhe matja e xhepave periodontalë dhe e indeksit gingival ku kishte predominancë tipi G2 në 40% të rasteve.




Grafiku 1: Grupi i pacientëve të ekzaminuar




Grafiku 2: Indeksi gingival në %

Nga ekzaminimet bakteriologjike të likidit të sulkusit gingival apo të salivës së rakoltuar me tamponë sterile dhe vendosjes në apgar- gjak, rezultoi prezenca e s.pneumoniae, clebsiella dhe streptokok β -hemolitik.

Në pacientët e pavijonit të patologjive të përgjithshme, ku kemi hasur një numër prej 70 pacientësh, prej të cilëve 39 femra dhe 31 meshkuj, grupmosha nga 19 deri në 85 vjeç me patologji renale, me hepatitis A, anemi hemokromocitare etj., kemi hasur situata klinike të cilat, falë patologjisë primare, shprehnin modifikime të ngjyrosjes së mukozave dhe të tegumenteve, kryesisht të zbehta në rastin e pacientëve anemikë, në pacientë me halitosis dhe glosodini, disguesi në rastin e pacientëve me problem renale, si dhe hemoragji gingivare spontane ose në trauma të lehta mastikatorë.



Grafiku 3: Grupi i pacientëve të ekzaminuar



Grafiku 4: Indeksi gingival në %

Në këtë grup pacientësh u vu re prezenca e indeksit gingival G2 i cili kishte prevalencë më të lartë, ndërsa në ekzaminimet mikrobiologjike u vu re prezenca e clebsiella, s.a-hemolitik, s.pneumoniae, s. aureus. U vu re vetëm në një rast të një pacienti me ikter (Jaundice). Mosha e pacientit ishte 19 vjeç dhe higjiena orale ishte e mirë, rezultatet laboratorike të ekzaminimit mikrobiologjik dolën negative.

Në pacientet e rajonit të sëmundjeve infektive u ekzaminuan 20 pacientë, 7 femra dhe 13 meshkuj, grupmosha

23 - 84 vjeç. Ky grup pacientësh prezantonte një higjienë të varfër, halitosis, gingivit. Më specifik ishte rasti i një pacienti D.S, gjinia femërore, mosha 54 vjeç e diagnostikuar me leprozë. Gjuha prezantonte në sipërfaqen dorsale pamje të fisuruar, mbivendosje keratozike si në nivelin e sipërfaqes dorsale të gjuhës, por edhe të mukozave bukale, labiale, komisurale^{5,6}. Vihej re një kserostomi e theksuar, e cila favorizonte shfaqjen e lezioneve karioze në nivel cervical, recesion gingival. Rezultati mikrobiologjik pozitiv: s.aureus, streptococcus b-hemolitik, s.oralis, clebsiella pneumoiae.



Figura 1, 2 tregon imazhe të një gjuhe fisuratum me depozita keratozike në sipërfaqen dorsale të saj dhe në mukozën e faqes dhe buzës inferiore.

Një grup prej 133 pacientësh u ekzaminua në Klinikën Universitare të Albanian University, nga të cilët 79 femra dhe 84 meshkuj të grupmoshave 18 deri në 85 vjeç, me prejardhje me prevalencë më të madhe nga mjedisi urban.

Nga ekzaminimi i tyre u vunë re pacientë të cilët prezantonin gjuhë fisuratum si variacion i normales, gjuhë gjeografike, kserostomi e cila favorizonte shfaqjen e kandida albicans, periodontit ulcero nekrotik, afte minor, dhe leziona traumatike me origjinë inkongruencën dento – alveolare apo spina irritative të dhëmbëve të dëmtuar në nivelin e kurorës etj.





Fig. 3 Gjuha fisuratum




Fig. 4 Gjuha gjeografike

U vu re se indeksi gingival predominant ishte G1.



Grafiku 5: Grupi i pacienteve të ekzaminuar



Grafiku 6: Indeksi gingival në %

Konkluzione: Në bazë të rezultateve të arritura pas ekzaminimit të pacientëve, diagnostikimit të patologjive dhe manifestimeve orale, arritëm këto konkluzione:

- Prevalencë e lartë për gingivit, periodontit, kandida, halitozis, glosit në pacientë me patologji renale, hepatike, hematologjike dhe diabet.
- Grupmosha me risk më të lartë është 50-70 vjeç, krahasuar me mosha më të reja.
- Indeksi gingival: G0=5%, G1=20% G2=30% G3=45%.
- Indeksi perio: P0=4% P1=6% P2=45% P6=30% P8=15%.
- Në likidin sulkular kanë rezultuar: *s.oralis, mitis, sanguis, b-hemolitik, clebsiella, staphilococcus a-hemolitik, b-hemolitik dhe pneumococcus*.
- Gjinia më e riskuar janë meshkujt në raportin 2:1 me femrat.

Bibliografia

1. Serban Tovar, Mihaela Tovar, Mariana Costache, Federica Demarosi,- Patologie Orala, vol.1, 2008, fq. 75- 87.
2. Canaan TJ, Meehan SC. -Variations of structure and appearance of the oral mucosa. 2005, 49; fq. 1-14.
3. Brad W. Neville, DDS, Douglas D. Damm, DDS, Carl M. Allen, DDS, MSD and Angela C. Chi, DMD- Oral and Maxillofacial Pathology, 4th Edition, 2016.
4. Parks ET, Lancaster H,- Oral manifestations of systemic disease 2003; 21(1):171 82
5. Gemaque K, Giacomelli Nascimento G, Cintra Junqueira JL, Cavalcanti de Araújo V, Furuse C. Prevalence of oral lesions in hospitalized patients with infectious diseases, 2014 Jan 15.
6. Sandeep S Gupta, Devi C Shetty, Aadithya B Urs, P NainaniJ. Role of inflammation in developmental odontogenic pathosis Oral Maxillofac Pathol. 2016 Jan-Apr; 20(1): 164.